REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
MUNICIPALITY SUHAREKË
OPSTINA- SUVA REKA

KRYETARI I KOMUNËS
01-Nr- 111 - 12230
ME DATE: 28.02.2022

Komuna e Suharekës duke u bazuar në nenin 34 pika 12 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 nenin 18 pika 1 dhe 2 paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrieren në Shërbomin Civil të Republikës së Kosovës Udhëheqësi më i lartë Administrativ bënë :

VAZHDIM I
SH P A LL J ES P U B L I K E

I. **Për angazhimin e ekspertit të jashtëm, për të qenë pjesë e Komisionit në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të kandidatëve për konkurset në pranim, ekspert të burimeve njerzore nga organizata të specializuara apo Univerzitet të fushës.**

Lokacioni vendi i punës Komuna e Suharekës

Paga fikse është: 250 Euro për ekspertin e angazhuar e cila paguhet për procedurën (grupin) e konkurimit.
Mandati do të jet dy (2) vjeqar.
Detyrat dhe përgjegjësitë:
Eksperti i jashtëm do të jet anëtar i komisionit për pranim në shërbimin civil dhe do të kryej detyrat e tij ashtu si janë përcaktuar në rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrieren në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e që janë:

- Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit dhe përvojës domethënëse në punë.
- Vlerësimin e trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëmine përkatëse.
- Vlerësimin e njohurive, aftësive apo cilësitë e kandidatit , nëpërmjet intervistës me gojë.

Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Diplomë universitare në fushën : Burime Njerëzore ose të Universitetit të fushës (Ekonomik, Juridik, Administratë Publike) me të paktën 240 kredi.
- Kontrata ose vërtetim që dëshmon marrëdhënjen e punës me Universitete të fushës.
- Për personat qe kanë diplomuar jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës nga MASHT-i.
- Së paku 4 vite përvoje pune pas diplomimit, në fushën profesionale të nivelit drejtues.
- Të mos jenë të emëruar politik
- Të mos jenë shërbyes civil
- Të ket inegritet moral dhe profesional
- Të mos jet i larguar nga sherbimi civil si rrjedhoj e masave diciplinore dhe të mos ket mas diciplinore në fuqi.
- Të drejtë konkurimi kanë kandidat nga organizatat të specializuara apo universitetet e fushës.

Angazhimi në cilësinë e ekspertit të jashtëm nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së punës në Komunën e Suharekës, mirëpo eksperti do të angazhohet për një periudhë të caktuar kohore.

Mënyra e aplikimit:
Kandidatet e interesuar duhet të paraqesin këto dokumente:

Kopjen e letërnjoftimi

- Një CV
- Dëshmi për shkollimin fotokopje e diplomes e vertetuar
- Dëshmi për përvojën e punës
- Dëshmi që nuk është nën hetime
- Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatët që aplikon.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Zyrën Pritëse të Komunës së Suharekës.

Shpallja mbetet e hapur 8 ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe Web faqen e Komunës së Suharekës.

Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim, në afat ligjor, ndërsa ata të cilët nuk hyjn në përzgjedhje nuk do të kontaktohen.
Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë , duhet të sjellin për verifikim të gjitha dokumentet origjinale. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të mbylljes së shpalljes nuk do të pranohen.
Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët e interesuar.

Kryetari i Komunës

Bali Muharremaj